



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA UŠLUGU VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



ARRU/UTSH-08/01-01/2016

09. 08. 2016

Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 19.1 të Ligjit Nr. 05/L-042, për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të datës 30 Janar 2016 ("Ligji").

Konform Nenit 15. të Rregullës për Përcaktim të Tarifave të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë të datës 24 Dhjetor 2012 (Rregulla ZRRUK R-02/U&K),

Duke u bazuar në të dhënat e aplikacionit për Tarifa Shërbimi të dorëzuara nga KUR "Prishtina" Sh. A. Prishtinë për procesin tarifarë 2015-2017 dhe analizës së të dhënave të realizuara të performancës së saj, gjatë 11 muorit të parë të vitit 2015, lëvizjeve inflatore të periudhës Dhjetor 2014–Nëntor 2015, rrethanave socio ekonomike në vend dhe implementimin e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 30. Lidhjet e pa autorizuar të Ligjit Nr. 05/L-042.

Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit (ARRU) lëshon këtë:

URDHËRESË PËR TARIFA SHËRBIMI

PËRCAKTIMI I TARIFAVE TË SHËRBIMET TË UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT PËR APLIKIM NGA KRU "PRISHTINA" Sh. A. PRISHTINË GJATE PERIUDHES TARIFORE 15. 08. – 31. 12. 2016 NGA PROCESI TARIFORE 2015-2017

1. Interpretimi

Në këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit (UTSH), përveç nëse konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe shprehjet me shkronja të mëdha do të kenë kuptimin që u atribuohen Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

2. Zbatueshmëria

Kjo Urdhëresë e Tarifave të Shërbimit është e zbatueshme dhe e detyrueshme për KUR "PRISHTINA" Sh. A., me rastin e faturimit të Shërbimeve të Ujësjetës dhe Kanalizimit që u ofron konsumatorëve të vet në tërë Zonën e saj të shërbimit.

ARRU mund t'i bëjë korrigjimet e jashtëzakonshme të tarifave të shërbimit në bazë të kërkesës së KUR "Prishtina" Sh. A., në pajtim me nenin 16 të Rregullës ZRRUK R-02/U&K.

3. Përmbajtja e shtojcave të UTSh-së

Shtojcat e kësaj Urdhërese Tarifore të Shërbimit përmbajnë;

- 3.1 *Shtojca Nr. 1: Lista e Tarifave të Shërbimit, me sqarimet përkatëse,*
 - 3.1.1 *Shtojca 1. Pika 3. nën pikat 3.5 dhe 3.6 nuk aplikohen më tutje, dhe*
- 3.2 *Shtojca Nr.2: Caqet operative, financiare dhe ato të investimeve kapitale të përcaktuara për t'u arrit nga kompania gjatë vitit 2016.*

Tarifat e përcaktuara në këtë UTSH janë pa TVSH.

4. Afati

Tarifat e përcaktuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit do të jenë të zbatueshme për periudhën **15. 08 deri me 31.12. 2016**, sipas procesit rregullator të tarifave të periudhës 2015-2017.

5. Publikimi dhe Shpërndarja e Listës së Tarifave të Shërbimit

- 5.1 KUR "PRISHTINA" Sh. A. duhet të shpërndajë Listën e Tarifave të Shërbimit të aprovuara me këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit, tek secili Konsumator në momentin e nënshkrimit të Kontratës për Shërbime ose së paku një herë në fillim të aplikimit të saj t'i bashkëngjis të njëjtën faturës me të cilën faturohen konsumatorët.
- 5.2 Lista e Tarifave për Shërbime e aprovuar nga ARRU nën këtë Urdhëresë të Tarifave të Shërbimit duhet të publikohet nga KUR "PRISHTINA" Sh. A., së paku në njërën prej gazetave ditore me tirazh gjithë përfshirës në tërë Kosovën, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës, pas shpalljes dhe publikimit të saj nga ARRU në portalin e internetit të vet; www.arru-ks.org.


6. Apelet


KUR "PRISHTINA" Sh. A. ka të drejtë të apelojë këtë urdhëresë ose pjesë të saja brenda një muaj, nga data e publikimit, tek Komisioni Shqyrtues i themeluar konform nenit 41.1, Komisioni Shqyrtues, Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të datës 30 Janar 2016.

7. Gjuhët Zyrtare të Urdhëresës për Tarifa Shërbimi

Kjo Urdhëresë për Tarifa të Shërbimit publikohet në tri (3) gjuhë, dy nga të cilat janë zyrtare që përdoren në Kosovë dhe në Gjuhën Angleze.

Në rast mospërputhje në mes të versioneve të UTSh-së do të mbizotërojë versioni i shkruar në gjuhën Shqipe.


Raif Preteni
Drejtor i ARRU



SHTOJCA 1: LISTA E TARIFAVE TË SHËRBIMIT

1. Tarifat Fikse dhe Tarifat Volumetrike për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Janar 2015 – 31 Dhjetor 2017

Kategoria e Konsumatorëve	Tarifa Fikse (EURO/muaj)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Ujësjellësit (EURO/m ³)	Tarifa Volumetrike për Shërbime të Kanalizimit (EURO/m ³)
1. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN 2015 (1 JANAR 2015 – 31 DHJETOR 2015)			
Shtëpiak	1.0	0.3850	0.0459
Institucional dhe Industrial/Komerical	3.0	0.8623	0.1050
1.1. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN KALENDARIK 2015 TË PËRCAKTUARA MBI BAZËN E INDEKSIT TË PROJEKSIONEVE TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA FMN PËR VITIN 2014 Të aplikueshme nga (1 JANAR 2015 – 31 DHJETOR 2015)			
Shtëpiak	1.0	0.39	0.05
Institucional dhe Industrial/Komerical	3.0	0.88	0.11
2. TARIFA PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN KALENDARIK 2016 (01.01.-31.12. 2016)			
Shtëpiak	1.0	0.3826	0.0457
Institucional dhe Industrial/Komerical	3.0	0.8533	0.1046
2.1. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN KALENDARIK 2016 MBI BAZËN E VLERESIMIT TË PERFORMANCES SE 11 MUJORIT TË PARË TË VITIT 2015, INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK, RRETHANAVE SOCIO-EKONOMIKE NË VEND PËR PERIUDHËN 01.06. – 31.12.2016			
Shtëpiak	1.0	0.39	0.05
Institucional dhe Industrial/Komerical	3.0	0.88	0.11
3. TARIFAT PA INFLACION TË PËRCAKTUARA PËR VITIN KALENDARIK 2017 (01.01. – 31.12. 2017)			
Shtëpiak	1.0	0.3784	0.0461
Institucional dhe Industrial/Komerical	3.0	0.8400	0.1013
3.1. TARIFAT E APLIKUESHME PËR VITIN KALENDARIK 2017 MBI BAZËN E VLERESIMIT TË PERFORMANCES, INDEKSIT TË ÇMIMEVE TË KONSUMIT TË PUBLIKUARA NGA ASK, RRETHANAVE SOCIO-EKONOMIKE NË VEND PËR PERIUDHËN 01.01. – 31.12.2017			
Shtëpiak	1.0		
Institucional dhe Industrial/Komerical	3.0		

Sqarim:

- Tarifat e vitit 2015 janë përcaktuar në bazë të procedurave rregullatore të aprovuara nga ARRU, pika 1.1.
- Tarifat e aplikueshme për konsumatorë për vitin 2016 pika 2.1. janë përcaktuar në bazë të analizave dhe vlerësimit të performances së kompanisë për 11 mujorin e parë të vitit 2015, lëvizjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë të publikuara nga ASK për periudhën (Dhjetor/2014 – Nëntor/2015) dhe rrethanave socio-ekonomike në vend.
- Tarifat e aplikueshme për konsumatorë për vitin 2017 pika 3.1. do të përcaktohen mbi bazën e njëjtë të procedurave të përshkruara tek pika b. për vitin 2016, përveç nëse krijohen rrethana tjera të cilat imponojnë tjetër zgjidhje të konsideruara si madhore. Dhjetor/2015 – Nëntor/2016.
- Tarifat fikse nuk i nënshtrohet rregullimit për inflacion gjatë këtij procesi rregullatorë të tarifave.

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

ICK – Indeksi i Çmimeve të Konsumit

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

2. Tarifat për administrim dhe shpenzimet për kycje në Rrjetin e Shërbimeve të Ujit

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Qershor 2016 – 31 Dhjetor 2016

2.1. Tarifa Administrative për Kycje në Shërbime*	Diametri i gypit të kycjes/ujëmatësi	Tarifa për kycje në shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) – Tarifa për administrim është e pakthyeshme dhe nënkuptojmë të drejtën e konsumatorit për tu kyç në rrjetin e shërbimeve të ujit dhe mbajtjen e tij në regjistrin e konsumatorëve aktiv për çështje të ndryshme administrative. Shumat e inkasuara për këtë destinim përdoren për zgjerimin e rrjetës së shërbimeve të ujit.	(13 – 25) mm	5.00
	32 mm	
	40 mm	
	50 mm	
	65 mm	
	80 mm	
	100 mm	
	150 mm	
2.2. Shpenzimet e Kycjes në Shërbime të Ujësijellësit*	Diametri i gypit të kycjes/ujëmatësit	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) - Shpenzimet e Kycjes në Shërbime përfshijnë shpenzimet e punës dhe materialit në vijim: qafore, pajisjet për kycje, gypat e kycjes në gjatësi deri 15 metra, ujëmatësi dhe dy valvula. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	(13 – 20) mm	120.00
	(25 – 32) mm	160.00
	(40 – 50) mm	220.00
	> 50mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.
2.3. Shpenzimet e Kycjes në Shërbimet e Kanalizimit *	Diametri i gypit të kycjes/ujëmatësit	Shuma (EURO)
Për të gjitha Kategoritë e Konsumatorëve (*) – Shpenzimet e Kycjes në Shërbime përfshijnë shpenzimin e punës dhe të materialit në vijim: elementet fazonike për kycje dhe gypat në gjatësi deri 15 metra. Punët tokësore dhe ato të betonit nuk janë të përfshira.	DN 110 mm	100.00
	DN 160 mm	120.00
	DN 200 mm	160.00
	> 200 mm	Do të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën.

3. Tarifat për Shërbimet Tjera

Afati i Aplikueshmërisë: 1 Qershor 2016 – 31 Dhjetor 2016

Lloji i Shërbimit	Shuma (EURO)
3.1. Dërgimi i njoftimit për ndërprerje i faturohet vetëm njëherë konsumatorit dhe atë pas dërgimit të njoftimit të dytë brenda vitit kalendarik, sipas Ligjit Nr 053/L-042, Neni dhe Rregullores ZRRUK R-04/U & K, neni 32.1 (b)	3.00
3.2. Shkyçja e Shërbimeve të Ujësjiellit	20.00
3.3. Rikycja e Shërbimeve të Ujësjiellit	20.00
3.4. Riparimi i rrjedhjeve në objektin e Konsumatorit	Duhet të llogaritet në bazë të çmimeve për material dhe punën
3.5. Shitja e ujit me cisterna të ujit – transporti deri në 5 km	20.00 EURO/5m3
3.6. Riparimi i ujëmatësit nga çmimi i ujëmatësit kur kompania e instalon ujëmatësit e saj	Max. 60% të çmimit të ujëmatësit
3.7. Kontrollimi i ujëmatësit – verifikimi i saktësisë	15.00

Shënim:

Mos aplikimi i pikave sipas UTSH-ës ARR/UTSH-08/01/2016, datë 31. 05. 2016 i janë referuar kostove të shërbimit të evidentuara sipas nën-pikave;

3.5. Gjopa për kyçje ilegale - në shumë prej 100.00 €

3.6. 3.6. Gjopa për moskryerje të riparimit të rrjedhjes në objektin e konsumatorit aplikohet pas vërejtjes së parë - në shumë prej 100.00 €

Nën-pikat e lartë cekura janë anuluar/stornuar për aplikim të mëtejshëm, prandaj pasqyra e pikës 3. Tarifat për shërbime- tani ka 7 nën-pika e jo 9 sa i kishte UTSH-ja e theksuar me numrin e lartë cekur të këtij shënimi.

Disa nga aspektet e këtyre shërbimeve janë të rregulluara edhe me Rregullën ZRRUK R-03/ U & K.

SHTOJCA 2: CAQET OPERATIVE, FINANCIARE DHE ATO TË INVESTIMEVE KAPITALE TË PËRCKTUARA PËR TU ARRIT NGA KOMPANIA GJATË VITIT 2016

Këto caqe paraqesin obligim kontraktual ndërmjet KRU-së dhe ARRU për t'u përmbush gjatë vitit kalendarik biznesor 2016 me përshtatjet e bëra për lëvizjet inflatore të periudhës së caktuar.

Caqet e aprovuara ndërmjet ZRRUK dhe KRU	Njësia	Viti 2016
1. Të dhënat operative		
1.1 Uji i prodhuar	m ³ /vit	44,433,884
1.2 Uji i humbur	m ³ /vit	19,393,388
1.3 Uji i faturuar	m ³ /vit	25,040,496
1.4 Numri i konsumatorëve	Nr	110,785
2. Të dhënat financiare		
2.1 Shpenzimet operative për shërbimet e ujit	€/vit	8,578,838
2.2 Shpenzimet operative për shërbimet e kanalizimit	€/vit	549,143
2.3 Shuma vjetore e shpenzimeve operative	€/vit	9,127,982
2.3.1 Shuma e zhvlerësimit	€/vit	495,526
2.3.1.1 Shuma e shpenzimeve operative + zhvlerësimi	€/vit	98,623,508
2.4 Faturimi për shërbimet e ujësjellësit	€/vit	13,821,866
2.5 Faturimi për shërbimet e kanalizimit	€/vit	1,348,087
2.6 Shuma e faturimit për dy shërbimet	€/vit	15,169,953
2.7 Arkëtimi për shërbimet e ujësjellësit	€/vit	11,071,830
2.8 Arkëtimi për shërbimet e kanalizimit	€/vit	1,091,073
2.9 Shuma e arkëtimit për dy shërbimet	€/vit	12,162,903
3. Të dhënat e investimeve kapitale		
3.1 Shuma e investimeve kapitale për pagesë të anuitetit të kredisë	€/vit	2,709,000
3.2 Shuma e investimeve kapitale për shërbimet e ujërave të zeza	€/vit	282,750
3.3 Shuma e investimeve tjera kapitale (projektet e ndryshme)	€/vit	1,360,257
3.4 Shuma e investimeve kapitale vetenake	€/vit	4,352,007
3.5 Investimet kapitale për shërbimet e ujit nga donatorët	€/vit	9,083,333
3.6 Investimet kapitale për shërbimet e kanalizimit nga donatorët	€/vit	0
3.7 Shuma e investimeve kapitale nga donatorët	€/vit	9,083,333

ARRU edhe gjatë këtij viti do të monitorojë të dhënat e arritura për treguesit kryesor nga kompanitë për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së objektivave të përcaktuara të cilat do të publikohen përmes tri raporteve periodike, 6,9 dhe 11 muajvetë parë të vitit 2016 dhe atë vjetor pas përmbylljes së vitit biznesor 2016.

Ekziston mundësia e saktësisimit të mëtejme të të dhënave të kësaj pasqyre pas verifikimit të të dhënave nga ARRU, ose KRU "Prishtina", nëse kërkohet nga ta.